



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

UDHËZIM ADMINISTRATIV MD - NR. 16/2023¹
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E UDHËZIMIT
ADMINISTRATIV (MD)-NR. 06/2019 PËR TRAJNIMIN DHE
CERTIFIKIMIN E NDËRMJETËSUESVE

¹ Udhëzim Administrativ MD - Nr. 16/2023 për ndryshimin dhe plotësimin e udhëzimit administrativ MD-Nr. 06/2019 për trajnimin dhe certifikimin e ndërmjetësuesve

Ministrja e Ministrisë së Drejtësisë

Në mbështetje të nenit 27, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-009 për Ndërmjetësim, (GZ Nr. 14/20 Gusht 2018 Prishtinë), në përputhje me nenin 11, paragrafi 1, nënparagrafin 1.5 të Ligjit Nr.08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, duke u bazuar në Shtojcën 1, pika 3 (paragrafi 3.1) të Rregullores (QRK) - NR. 14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive si dhe nenin 38 paragrafi 6 të Rregullores së punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011 (Gazeta Zyrtare Nr. 15, data 12.09.2011);

Nxjerrë:

UDHËZIM ADMINISTRATIV MD - NR. 16/2023 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E UDHËZIMIT ADMINISTRATIV (MD) -NR. 06/2019 PËR TRAJNIMIN DHE CERTIFIKIMIN E NDËRMJETËSUESVE

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i këtij Udhëzimi Administrativ është ndryshimi dhe plotësimi i Udhëzimit Administrativ MD-Nr. 06/2019 për Trajnimin dhe Certifikimin e ndërmjetësuesve (tutje: Udhëzimi bazik).

Neni 2

1. Paragrafi 1 i nenit 3 të Udhëzimit bazik ndryshohet si në vijim:

1. Ministria e Drejtësisë bënë shpalljen publike të konkursit për përzgjedhjen e kandidatëve për të ndjekur trajnimin për ndërmjetësues në Republikën e Kosovës në të dy gjuhët zyrtare dhe i njëjti emetohet në transmetuesin publik po ashtu në dy gjuhët zyrtare.

2. Paragrafi 7 i nenit 3 të Udhëzimit bazik ndryshohet si në vijim:

7. Kundër vendimit nga paragrafi 6 i Udhëzimit bazë, kandidati ka të drejtë t'i paraqesë ankesë Ministrit në afat prej pesëmbëdhjete (15) ditësh nga dita e pranimit të vendimit. Ministri brenda pesë (5) ditësh nga përfundimi i afatit të ankesave vendos lidhur me ankesën e parashtruesit. Vendimi i Ministrit është përfundimtar.

Neni 3

1. Paragrafi 1 i nenit 4 të Udhëzimit bazik, ndryshohet si në vijim:

1. Për certifikim si ndërmjetësues në Republikën e Kosovës, kandidati duhet të ketë kryer dyzet (40) orë trajnim bazik dhe dyzet (40) orë trajnim të specializuar të ofruar nga Ministria e Drejtësisë.

2. Paragrafi 4 i nenit 4 të Udhëzimit bazik, ndryshohet si në vijim:

4. Programi i trajnimit për ndërmjetësues përmban pjesë teorike dhe praktike mbi ndërmjetësimin dhe reflekton lëndët e përcaktuara në shtojcën 2 e cila është pjesë përbërëse e këtij Udhëzimi Administrativ.

Neni 4

1. Neni 5 i Udhëzimit bazik, riformulohet si në vijim:

1. Pas përfundimit të trajnimit fillestar prej dyzet (40) orësh, kandidatët do t'i nënshtrohen vlerësimit nga trajnerët përkatës që e kanë zhvilluar trajnimin.

2. Pas përfundimit të trajnimit të specializuar prej dyzet (40) orësh, kandidati do t'i nënshtrohet vlerësimit nga trajnerët përkatës që e kanë zhvilluar trajnimin.

3. Për t'u certifikuar për ndërmjetësues, kandidati duhet të ketë përfunduar katër (4) seanca ndërmjetësimi, të ndërmjetësuara bashkë me trajnerin, brenda një periudhe prej gjashtë (6) muajsh. Kandidati do t'i nënshtrohen vlerësimit nga trajnerët përkatës që e kanë zhvilluar trajnimin.

4. Vlerësimi i kandidatëve bëhet me “Kalon” ose “Nuk kalon”.

Neni 5

Ndryshohet dhe plotësohet Shtojca 2 e Udhëzimit bazik - Programi për trajnimin fillestar të ndërmjetësuesve.

Neni 6 Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albulena Haxhiu

Ministre e Drejtësisë

30/11/2023

SHTOJCA 2

PROGRAMI PËR TRAJNIMIN FILLESTAR DHE TË SPECIALIZUAR TË NDËRMJETËSUESVE

1. Nocioni i Zgjidhjes Alternative të Kontesteve - nocioni i Ndërmjetësimit;
2. Korniza Ligjore e Ndërmjetësimit në Republikën e Kosovës;
3. Parimet Themelore të Ndërmjetësimit;
4. Fazat e procedurës së Ndërmjetësimit;
5. Efikasiteti i procedurës së Ndërmjetësimit;
6. Dallimi në mes të procedurës së Ndërmjetësimit dhe asaj Gjyqësore;
7. Rruga deri te Arritja e Marrëveshjes përmes Negocimit;
8. Ndërmjetësimi me qasje gjinore;
9. Aftësitë Komunikuese;
10. Mënyrat për të ndërtuar dhe përmirësuar raportet në mes palëve;
11. Analiza e ndërmjetësuesit për çështjet, pozicionet dhe interesat e palëve;
12. Njohuritë lidhur me modelet dhe proceset aktuale të ndërmjetësimit vendor dhe ndërkombëtar;
13. Standardet e praktikës ndërmjetësuese, çështjet etike dhe disiplinore të ndërmjetësuesve;
14. Simulimi Praktik i Ndërmjetësimit;
15. Shikimi dhe analizimi i video-incizimeve të Ndërmjetësimit;
16. Etika dhe Disiplina e Ndërmjetësuesve;
17. Hartimi i marrëveshjes së ndërmjetësimit.

KURRIKULA - PËR TRAJNIMIN FILLESTAR DHE TË SPECIALIZUAR TË NDËRMJETËSUESVE

OBJEKTIVAT E KURRIKULËS

Kurrikula është hartuar për të siguruar zbatimin e Udhëzimit Administrativ MD-Nr. 06/2019 për trajnimin dhe certifikimin e ndërmjetësuesve. Qëllimi i kurrikulës është të sigurojë që pjesëmarrësit të mund të demonstrojnë zotërim të aftësive dhe kompetencave thelbësore të ndërmjetësuesit, si përmes një provimi me shkrim, ashtu edhe përmes vlerësimit të bazuar në performancë.

Për t'i demonstruar me sukses këto kompetenca, pjesëmarrësit duhet të kalojnë kursin dyzet (40) orë të trajnimit bazik për ndërmjetësim dhe dyzet (40) orë trajnim të specializuar dhe të demonstrojnë me sukses zotërimin e aftësive bazike të ndërmjetësimit gjatë katër (4) seancave të bashkë-ndërmjetësimeve me një ndërmjetësues/trajner të certifikuar të Akademisë së Drejtësisë së Kosovës.

Pas përfundimit të trajnimit bazik dyzet (40) orë, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Zbatojnë kërkesat ligjore për ndërmjetësim;
- Dallojnë ndërmjetësimin dhe shpjegojnë ndryshimin midis ndërmjetësimit dhe proceseve të tjera të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve;
- Ushtrojnë drejtë funksionin e ndërmjetësuesit;
- Zbatojnë procesin e ndërmjetësimit sipas tetë (8) fazave të përcaktuara;
- Njohin dinamikën e konfliktit në ndërmjetësim;
- Zbatojnë shkathësi të komunikimit gjatë procesit të ndërmjetësimit;
- Njohin palët dhe interesat e tyre në procesin e ndërmjetësimit;
- Simulojnë procesin e ndërmjetësimit drejtë sipas 8 fazave.

Pas përfundimit të trajnimit të specializuar prej dyzet (40) orë pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Zbatojnë kërkesat ligjore për ndërmjetësimin e detyrueshëm;
- Aplikojnë ndërmjetësimin sipas kërkesave ligjore në çështjet e punësimit, marrëdhëniet e punës, kontratave, tregtisë, blerjeve, falimentimit, trashëgimisë dhe çështjeve penale;
- Menaxhojnë sjelljet e palëve në procesin e ndërmjetësimit;
- Demonstrojnë shkathësi në ndërmjetësimin e çështjeve pronësore, familjare dhe komerciale;
- Hartojnë marrëveshje ndërmjetësimi ligjërisht të zbatueshme;
- Zotërojnë kompetencat thelbësore të ndërmjetësuesit përmes praktikave intensive të simulimit të rasteve të ndërmjetësimit.

Pasi të kenë përfunduar katër (4) seancat e ndërmjetësimit, të ndërmjetësuar bashkë me trajnerin, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Demonstrojnë me sukses zotërimin e kompetencave thelbësore të ndërmjetësuesit të përshkuara në fletën e vlerësimit përfundimtar për certifikim.

Ofruesit e trajnimit

- Trajnimet për ndërmjetësues i organizon Ministria e Drejtësisë përmes ndërmjetësuesve trajnerë të certifikuar.

PËRMBAJTJA E TRAJNIMIT

Trajnimi dyzet (40) orë për ndërmjetësimin bazik

- Njohuritë e përgjithshme të legjislacionit në fushën e ndërmjetësimit;
- Njohuritë mbi kodin e etikës së të ndërmjetësuesit;
- Përkufizimi i ndërmjetësimit dhe zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjeve;
- Roli i ndërmjetësuesit dhe sjelljet efektive të ndërmjetësuesit;
- Përkufizimi i parimeve të-ndërmjetësimit.

Aftësitë themelore të ndërmjetësuesit:

- Dëgjimi aktiv;
- Bërja e pyetjeve efektive;
- Dallimi i qëndrimeve nga interesat;
- Parafrazimi, formulimi dhe riformulimi;
- Shkëmbimi i mendimeve dhe krijimi i opsioneve.

Procesi i ndërmjetësimit në tetë (8) hapa:

- Hapi i parë - Planifikimi i seancës së ndërmjetësimit;
- Hapi i dytë - Deklaratat hyrëse të ndërmjetësuesit;
- Hapi i tretë - Deklaratat fillestare të palëve;
- Hapi i katërt - Hartimi i agjendës;
- Hapi i pestë - Negocimi;
- Hapi i gjashtë - Takimi i palës;
- Hapi i shtatë - Hartimi i marrëveshjeve;
- Hapi i tetë - Përmbledhja e ndërmjetësuesit.

Dinamika e ndërmjetësimit:

- Konflikti, fuqia, të drejtat dhe interesat;
- Mjetet e komunikimit të ndërmjetësuesit;
- Ballafaqimi me sjellje të vështira dhe emocione të forta;

- Aplikimi i përmbajtjes përmes katër (4) rasteve të simuluar përmes lojës me role.

Trajnim i specializuar dyzet (40) orë

Trajnime të specializuara të modulit lëndor (8 orë)

- Ndërmjetësimi i detyrueshëm;
- Marrëdhëniet e punës ;
- Kontratat;
- Tregtia/blerjet;
- Falimentimi dhe trashëgimia;
- Lëndët penale (me simulim të rasteve).

Praktika e specializuar e trajnimit për lëndën pronësore tetë (8) orë

- Aspektet unike të kontesteve pronësore në Kosovë;
- Qasja dhe mjetet specifike të ndërmjetësimit të kontesteve pronësore;
- Dy (2) simulime intensive të rasteve që përfshijnë çështje pronësore (grupe me 4 persona, bashkë-ndërmjetësuesit dhe 2 palët, secili simulim i rasteve zgjat 2 orë).

Praktika e specializuar të trajnimit për lëndën familjare tetë (8) orë

- Aspektet unike të së drejtës familjare në Kosovë;
- Qasja dhe mjetet specifike të ndërmjetësimit familjar;
- Dy (2) simulime intensive të rasteve që përfshijnë çështje familjare (grupe me 4 persona, bashkë-ndërmjetësuesit dhe 2 palët, secili simulim i rasteve zgjat 2 orë).

Praktika e specializuar e trajnimit për lëndën komerciale tetë (8) orë

- Aspekte unike të së drejtës komerciale në Kosovë;
- Qasja dhe mjetet specifike të ndërmjetësimit në çështje komerciale;
- Dy (2) simulime intensive të rasteve që përfshijnë çështje komerciale grupe me 4 persona, bashkë-ndërmjetësuesit dhe 2 palët, secili simulim i rasteve zgjat 2 orë).

Trajnim për hartimin e marrëveshjeve tetë (8) orë

- Lloji i zgjidhjeve (të mosmarrëveshjeve);
- Kërkesat ligjore për marrëveshjet për zgjidhjen e rasteve;
- Njohja e gjuhës hartuese/juridike;
- Aftësia e demonstruar për të hartuar marrëveshje ligjërisht të mjaftueshme duke pasur parasysh mostrën e pikave të zgjidhjes përmes praktikumit.

Përfundimi i katër (4) seanceve të ndërmjetësimit, të ndërmjetësuar bashkë me trajnerin e certifikuar

- Përfundimi i katër (4) seanceve të ndërmjetësimit, të ndërmjetësuar bashkë me trajnerin.
- Kandidatët do të kalojnë nëpër një proces të vlerësimit nga trajneri dhe duhet të demonstrojnë me sukses zotërimin e kompetencave thelbësore të ndërmjetësuesit të përshkruara në Fletën e vlerësimit përfundimtar për certifikim.

Përbërja e grupit

Trajnimet organizohen në grupe me jo më shumë se 30 kandidatë, ashtu që mos ketë më pak se 1 trajner për çdo 10 pjesëmarrës.

Metodologjia e trajnimit

Kurset e trajnimit për aftësitë e ndërmjetësuesit janë të fokusuar në përgatitjen e kandidatëve për të praktikuar ndërmjetësimin. Ato duhet të jenë pjesëmarrëse, ndërvepruese dhe të fokusuar tek kandidatët. Për të siguruar këtë, duhet të përdoren një sërë metodologjish mësimore, përfshirë ligjërimin, videot, ushtrimet ndërvepruese, punën individuale, diskutimin në grup, të folurit në çifte dhe lojën e roleve. Për pjesën praktike të çdo kursi që është i dizajnuar për të mësuar procesin dhe aftësitë për të qenë ndërmjetësues efektiv, përqindja e kohës që duhet të shpenzohet në këto qasje të ndryshme në ofrimin e trajnimit është:

- Ligjërata/njohuri/prezantime – 10%;
- Ushtrime dhe diskutime – 40%;
- Luajtja e roleve-dhe të folurit në çifte -50%.

Materialet e pjesëmarrësve

Materialet e trajnimit do të përfshijnë:

- Doracakun/librin e punës për kursin;
- Materialet plotësuese siç është udhëzimi përgjithshëm për të luajtur rolet;
- Rregullat dhe procedurat e ndërmjetësimit, legjislacioni përkatës

Dhënia e komenteve (informacioneve kthyese)

- Pjesëmarrësit mësojnë jo vetëm duke praktikuar aftësitë e ndërmjetësuesve, por edhe duke marrë koment nga ndërmjetësuesit me përvojë që janë në rolin e trajnerëve gjatë gjithë kursit.
- Në trajnime do të përdoren një sërë metodash të ndryshme për të dhënë komente:
- Stërvitjet në grup gjatë luajtjes së roleve.
- Shkëmbimi i komenteve vetëm private njëri me tjetrin, pas lojës me role.

Vlerësimi i performancës dhe akreditimi

- Kandidatët do të vlerësohen përmes një provimi me shkrim dhe vlerësimeve të bazuara në performancë. Vlerësimi i kandidatëve bëhet me “Kalon” ose “Nuk kalon”.
- Pas përfundimit të trajnimit fillestar prej 40 orësh dhe përfundimit të trajnimit të specializuar prej 40 orësh, kandidatët do t'i nënshtrohen vlerësimit nga trajnerët që e kanë mbajtur trajnimin.
- Për t'u certifikuar për ndërmjetësues, çdo kandidat duhet të ketë kryer katër (4) seanca ndërmjetësimi, të bashkë-ndërmjetësuar me trajnerin. Kandidatët do të kalojnë nëpër një proces të vlerësimit nga trajneri lidhur me performancën e tyre. Kandidatët duhet të demonstrojnë me sukses zotërimin e kompetencave thelbësore të ndërmjetësuesit të përshkruara në (Fleta e punës për vlerësimin përfundimtar për certifikim).

Kurrikula e trajnimit bazik dyzet (40) orë për ndërmjetësues

Objektivi 1.	Pjesëmarrësit mund të përshkruajnë kërkesat ligjore për ndërmjetësim
1.1	Njohin dhe interpretojnë Ligjin për Ndërmjetësimin dhe aktet nënligjore;
1.2	Shpjegojnë tarifën e ndërmjetësimit;
1.3	Njohin detyrimet etike për ndërmjetësuesit e licencuar.
Objektivi 2	Pjesëmarrësit mund të përkufizojnë ndërmjetësimin dhe të shpjegojnë dallimin ndërmjet ndërmjetësimit dhe proceseve të tjera të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve
2.1	Përkufizojnë ndërmjetësimin;
2.2	Spjegojnë procesin e ndërmjetësimit dhe përfitimet;
2.3	Të bëjnë dallimin ndërmjet ndërmjetësimit dhe proceseve të tjera të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve.
Objektivi 3	Pjesëmarrësit mund të përshkruajnë rolin e ndërmjetësuesit
3.1	Përshkruajnë rolin e ndërmjetësuesit, sfidat e mundshme dhe çfarë do të thotë sukses për një ndërmjetësues;
	Të identifikojnë sjelljet efektive të ndërmjetësuesit;
3.2	
3.3	Të shpjegojnë konfidencialitetin dhe neutralitetin;
3.4	Të identifikojnë se çfarë krijon besimin dhe marrëdhënien me palët.

Objektivi 4	Pjesëmarrësit mund të përkufizojnë 8 fazat e procesit të ndërmjetësimit dhe të përshkruajnë rolin e ndërmjetësuesit dhe palëve në secilën fazë
4.1	Të shpjegojnë fazën fillestare të planifikimit dhe përcaktimit të pritjeve nga procesi dhe të përshkruajnë rolin e ndërmjetësuesit dhe palëve;
4.2	Të shpjegojnë elementët kryesorë në deklaratën hyrëse të ndërmjetësuesve dhe rolin e ndërmjetësuesit dhe palëve gjatë asaj faze të procesit;
4.3	Të shpjegojnë fazën fillestare të procesit ku jepen deklaratat e palëve dhe të përshkruajnë rolin e ndërmjetësuesit dhe palëve;
4.4	Të shpjegojnë fazën e procesit ku përpilohet agjenda dhe identifikohen çështjet dhe të përshkruajnë rolin e ndërmjetësuesit dhe palëve;
4.5	Të shpjegojnë fazën e procesit ku bëhen negociatat dhe arrihen marrëveshjet dhe të përshkruajnë rolin e ndërmjetësuesit dhe palëve;
4.6	Të shpjegojnë fazën e procesit ku zhvillohen bisedat e njëjës palë me ndërmjetësuesin dhe të përshkruajnë rolin e ndërmjetësuesit dhe rolin e palës;
4.7	Të shpjegojnë hartimin e marrëveshjeve dhe fazën përfundimtare të procesit dhe të përshkruajnë rolin e ndërmjetësuesit dhe palëve;
4.8	Të shpjegojnë fazën e procesit ku ndërmjetësuesi bën përmbledhjen.
Objektivi 5	Pjesëmarrësit mund të shpjegojnë dinamikën e konfliktit në ndërmjetësim
5.1	Të përkufizojnë konfliktin;
5.2	Të përshkruajnë burimet e mundshme të konfliktit në një mosmarrëveshje (kompetenca, të drejtat dhe interesat;
5.3	Të identifikojnë arsyet pse palët zgjedhin të qëndrojnë në konflikt dhe opsionet se si mund të dalin nga konflikti.
Objektivi 6	Pjesëmarrësit mund të shpjegojnë aftësitë themelore të komunikimit të ndërmjetësuesit dhe të demonstrojnë kapacitetin për të përdorur secilën aftësi
6.1	Të përkufizojnë dëgjimin aktiv;
6.2	Të demonstrojnë aftësinë për të dëgjuar qëndrimet, interesat si dhe nevojat dhe emocionet mbi të cilat bazohen ato;
6.3	Të përdorin aftësitë e dëgjimit aktiv për të demonstruar se i kuptojnë dhe nuk i gjykojnë nevojat, interesat dhe perspektivën e palëve të tjera;
6.4	Të përkufizojnë pyetjet efektive të ndërmjetësuesit;

6.5	Të demonstrojnë aftësinë për të bërë pyetje të hapura, pyetje të fokusuara në zgjidhje dhe pyetje me qëllim të caktuar;
6.6	Të përkufizojnë parafrazimin, formulimin dhe riformulimin;
6.7	Të demonstrojnë aftësinë për parafrazim për të konsoliduar dhe nxjerrë në pah pikat kryesore, për formulim të ideve për t'u mundësuar palëve të shikojnë çështjen nga këndvështrime të ndryshme dhe për riformulim të deklaratave nga deklaratat negative në deklaratat pozitive;
6.8	Të dallojnë ndjeshmërinë (empatinë) nga keqardhja dhe të demonstrojnë aftësinë për të përdorur ndjeshmërinë.
Objektivi 7	Pjesëmarrësit mund të dallojnë qëndrimet nga interesat dhe të demonstrojnë aftësinë për të ndihmuar palët që të përdorin interesat për të krijuar opsione për zgjidhje
7.1	Të përkufizojnë ndryshimin midis negociatave kundërshtare (qëndrimore) dhe negociatave të bazuara në interes;
7.2	Të përkufizojnë qëndrimet dhe interesat;
7.3	Të demonstrojnë aftësinë për të dalluar një interes nga një qëndrim;
7.4	Të demonstrojnë aftësinë për të ndihmuar palët të largohen nga qëndrimet dhe të zbulojnë interesat themelore.
7.5	Pjesëmarrësit demonstrojnë aftësinë për të ndihmuar palët të përdorin interesat për të shkëmbyer ide të vlefshme për të krijuar opsione për zgjidhje
7.6	Të i ndihmojnë palët të vlerësojnë opsionet bazuar në standardet e dakorduara në mënyrë të ndërsjellë, siç p.sh., a është e zbatueshme, e drejtë, e përballueshme, praktike dhe e pranueshme për të gjitha palët
Objektivi 8	Pjesëmarrësit mund të demonstrojnë aftësinë për të kryer secilën nga 8 fazat e procesit të ndërmjetësimit në ndërmjetësimet e simuluar
8.1	Të demonstrojnë aftësinë për të kryer fazën e para-ndërmjetësimit duke përfshirë dhënien e udhëzimeve të qarta për logjistikën e seancës së ndërmjetësimit, duke iu përgjigjur pyetjeve ose shqetësimeve të palëve në lidhje me procesin e ndërmjetësimit dhe duke përcaktuar pritshmërinë për palët në lidhje me ndërmjetësimin;
8.2	Të demonstrojnë aftësinë për të bërë një deklaratë hyrëse e cila i mbulon elementet kryesore, përfshirë, pjesën hyrëse, përkufizimin e ndërmjetësimit dhe fazat e procesit, rolin e ndërmjetësuesit, rolet e palëve, konfidencialitetin, rregullat bazë, pajtimin për të ndërmjetësuar, tarifën, afatin kohor të ndërmjetësimit dhe logjistikën;

8.3	Të demonstrojnë aftësinë për të krijuar terrenin për deklaratat fillestare të palëve, të inkurajojnë secilën palë që të ndajë pikëpamjen e tyre për rastin dhe të dëgjojnë në mënyrë aktive kur ata flasin;
8.4	Të demonstrojnë aftësinë për të identifikuar çështjet kryesore që i dëgjuan nga deklaratat fillestare të secilës palë dhe t'i përdorin ato çështje për të krijuar një agjendë të shkruar e cila i paraqet çështjet në mënyrë neutrale;
8.5	Të demonstrojnë aftësinë për të ndihmuar palët të negociojnë duke u ndihmuar atyre të eksplorojnë interesat, të ndërtojnë opsionet, të vlerësojnë dhe të ngushtojnë çështjen për të përcaktuar kushtet e zgjidhjes;
8.6	Të demonstrojnë aftësinë për të shpjeguar pritshmëritë nga bisedat individuale të palëve me ndërmjetësuesin, konfidencialitetin dhe logjistikën dhe të përdorin teknika specifike të bisedës së palëve me ndërmjetësuesin, si p.sh. duke bërë pyetje shpjeguese ose testuese rreth perceptimit dhe duke ndihmuar palët të krijojnë ide se si të vazhdojnë tutje;
8.7	Të demonstrojnë aftësinë për të hartuar marrëveshje ligjërish të mjaftueshme që përfshijnë kushte që janë specifike, të matshme, të arritshme, të rëndësishme dhe të bazuara në kohë;
8.8	Të demonstrojnë aftësinë për të bërë përmbledhje të çdo ndërmjetësimi.

Trajnim i specializuar dyzet (40) orë

Objektivi 1	Pjesëmarrësit mund të përshkruajnë njohuritë bazike të nevojshme për të ndërmjetësuar në ndërmjetësim të detyrueshëm, në marrëdhënie punësimi/pune, kontrata, tregti/blerje, çështje penale, falimentimi/trashëgimie, komerciale, familjare dhe pronësore
1.1	Përshkruajnë parimet bazë dhe komponentët ligjorë për secilën fushë lëndore.
Objektivi 2	Pjesëmarrësit mund të përshkruajnë në nivelin bazik qasjet dhe mjetet unike të ndërmjetësimit që kërkohen në çështjet familjare, pronësore dhe komerciale
2.1	Të shpjegojnë aspektet unike dhe të dallojnë se cilat qasje dhe mjete janë të përshtatshme për secilën fushë.
Objektivi 3	Pjesëmarrësit mund të demonstrojnë aplikim efektiv të këtyre qasjeve dhe mjeteve unike në çështjet familjare, pronësore dhe komerciale
3.1	Të demonstrojnë në praktikë simulimet e ndërmjetësimeve dhe përdorimin e duhur të këtyre qasjeve dhe mjeteve unike
Objektivi 4	Pjesëmarrësit mund të shpjegojnë dhe demonstrojnë zotësi në shkrimin e marrëveshjeve të zgjidhjes

4.1	Të përkufizojnë elementet thelbësore për marrëveshje të ndryshme
4.2	Të hartojnë marrëveshje ndërmjetësimi që përfshijnë komponentët e nevojshëm ligjor
4.3	Të hartojnë marrëveshjet S.M.A.R.T.

Kërkesat e performancës për certifikim

Objektivi 1	Demonstrimi i zotërimit të kompetencave thelbësore të ndërmjetësuesit të përshkruara në Fletën e Punës për Vlerësimin Përfundimtar për Certifikim
	Objektivi i ndërmjetëm
1.1	Kandidati për ndërmjetësues do të kryejë kate (4) sesione të bashkë-ndërmjetësimit me ndërmjetësues/trajnerë të licencuar të ADK-së
1.2	Ndërmjetësuesi trajner i licencuar i ADK-së vërteton se kandidati për ndërmjetësues demonstroi një zotërim të ndërmjetësimit bazik të përshkruar në Fletën e Punës për Vlerësimin Përfundimtar për Certifikim

Fleta e punës për vlerësimin përfundimtar për certifikim

Ju lutemi jepni komente konstruktive për ndërmjetësuesin e lojës me role		
HAPJA NGA NDËRMJETËSUESI		
DETYRA	PO/JO	SHËNIME
Ambienti i seancës së ndërmjetësimit	P/J	
Përshëndetja e palëve/hyrja	P/J	
Përgëzimi i palëve për pjesëmarrje	P/J	
Shpjegimi i aspektit vullnetar	P/J	
Shpjegimi i neutralitetit dhe roleve	P/J	
Shpjegimi i konfidencialitetit	P/J	
Shpjegimi i procesit (dhe biseda e palëve me ndërmjetësuesin)	P/J	
Shpjegimi i rregullave të punës	P/J	

Ka pyetur nëse ka pyetje	P/J	
Toni efektiv i zërit dhe kadenca e të folurit	P/J	
Ndërtimi i besimit dhe marrëdhënieve me palët	P/J	
Kalimi në deklaratat hyrëse të palëve	P/J	
DEKLARATAT E HAPJES E PALËVE DHE NDËRTIMI I AGJENDËS		
DETYRA	PO/JO	SHËNIME
Bërja e pyetjeve të hapura siç duhet	P/J	
Riformulimi/rishkrimi në mënyrë të duhur	P/J	
Përmbledhja e interesave dhe pikave kryesore	P/J	
Identifikimi i çështjeve kryesore në agjendë	P/J	
Pikat e rendit të ditës të formuluar si duhet në mënyrë neutrale	P/J	

SEANCA E PËRBASHKËT, NEGOCIMI I PALËVE ME NDËRMJETËSUESIN DHE PËRMBYLLJA		
DETYRA	PO/JO	SHËNIME
Mbajtja e procesit nën kontroll	P/J	
Adresimi i ndërprerjeve	P/J	
Përdorimi i modeleve të dëgjimit efektiv	P/J	
Përdorimi i pyetjeve efektive	P/J	
Lehtësimi i bisedës mes palëve	P/J	
Ndihma për palët që të dallojnë qëndrimet nga interesi	P/J	
Negocimi me palët (pushimet në kohën e duhur, trajtimi i konfidencialitetit)	P/J	
Ndihma për palët që të dalin me ide dhe të krijojnë opsione	P/J	
Përdorimi i pyetjeve efektive për testimin e realitetit dhe spekulimeve	P/J	
Marrëveshja e zgjidhjes është SMART (Specifike, e matshme, e arritshme, e rëndësishme dhe e bazuar në kohë)	P/J	

Përmbyllja	P/J	
Ruajtja e neutralitetit	P/J	
Menaxhimi i kohës – ua kushton kohën dhe vëmendjen e nevojshme palëve	P/J	
Ekspertiza – Njohuri të mjaftueshme për të ndërmjetësuar këtë lloj të mosmarrëveshjes	P/J	
Aftësia e përgjithshme e neutralitetit në përgjithësi	P/J	

Komente shtesë:

Gjëra për të diskutuar në përmbledhje

- Për çka krenoheni më së shumti?
- Çfarë mund të kishit bërë ndryshe?
- Lëvdatë për veprim ose mosveprim specifik.
- Identifikimi i stileve personale të ndërmjetësimit dhe opsioneve për ndërmjetësimin e ardhshëm.